



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0250

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Kimete Gashi Brajshori duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “FST Engineering” SH.P.K., kundër Vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit të “KOMUNA E PEJËS” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Hartimi i Projekti kryesor i objektit Administrativ Komunal -Pejë” me numër të prokurimit 635-24-6877-4-2-3, me 04/06/2025, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE “FST Engineering” SH.P.K. me nr. 2025/0250, e datës 08/04/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Hartimi i Projekti kryesor i objektit Administrativ Komunal -Pejë” me numër të prokurimit 635-24-6877-4-2-3.

2. Vërtetohet Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues për anulimin e aktivitetit të prokurimit nga AK – “KOMUNA E PEJËS” lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të dispozitivit.

3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

4. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik “FST Engineering” SH.P.K.

5. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si pjesërisht e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me datën 05.07.2024 “KOMUNA E PEJËS” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B06 Njoftim për Konkursin e Projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Hartimi i Projekti kryesor i objektit Administrativ Komunal -Pejë” me nr. të prokurimit: 635-24-6877-4-2-3.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurën e hapur, lloji i kontratës: konkurs projektimi, vlera e parashikuar e kontratës: 24,300.00 €.

Me 28.03.2025, “FST Engineering” SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 01.04.2025, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si te pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 08.04.2025, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “FST Engineering” SH.P.K., me nr. 2025/0250 për lidhur me aktivitetin “Hartimi i Projekti kryesor i objektit Administrativ Komunal -Pejë” me nr. të prokurimit 635-24-6877-4-2-3.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, OSHP-ja ka nxjerrë vendimin nr. 2024/0838 të datës 08.11.2024 dhe vendimin nr. 2025/0012 të datës 12.03.2025.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “FST Engineering” SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Me date 26.03.2025 AK ka publikuar në sistemin e-prokurimi, vendimin për anulimin e procedurës së lartcekur duke dhënë disa sqarime për mangësitë në projektet e secilit Operator Ekonomik (Gjeni bashkangjitur me këtë kërkesë vendimin e komisionit vlerësues). Në si OE kemi qenë të angazhuar në këtë projekt që nga fillimi dhe i kemi përcjellë të gjitha fazat duke bërë të qartë padrejtësinë e Komisionit Vlerësues ndaj nesh si OE, dhe favorizimin e Komisionit Vlerësues ndaj një OE të caktuar edhe në ankesat paraprake. Në si pjesëmarrës në konkursin e Projektimit vlerësojmë se Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit është një jo profesionalizëm dhe diskriminim i qartë, specifikisht ndaj nesh si OE duke u mundur që ne çdo mënyrë të perzgjidhet fitues i tenderit OE për të cilin ne kemi bërë ankesë disa herë (i gjeni të gjitha të radhura kronologjikisht me siper tek “Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit”), dy ankesa prej të cilave janë bërë në “Organin Shqyrtues të Prokurimit”, të cilat gjithashtu u vlerësuan nga Paneli Shqyrtues i OSHP si plotësisht të BAZUARA. Vendimi i AK për anulimin e Aktivitetit të Prokurimit duke u arsyetuar me disa komente duke u referuar në disa “mangësi” në projekte është i ekzagjeruar duke marrë parasysh se ato “mangësi” në projekte janë të pa përfundimshme dhe si të tilla mund të detajizohen në projektin kryesor për ekzekutim, dhe është e pa arsyeshme të anulohet komplet Aktiviteti i Prokurimit për këto arsye, duke marrë parasysh se Vlerësimi i Koncepteve të Projekteve do të bëhet me sisteme të pikeve, prandaj për ato “mangësi” ka mundur që të zbriten pike e jo të anulohet komplet Aktiviteti. Me tutje po i listojmë Komentet e vlerësimit nga Komisioni Vlerësues lidhur me projektin e

dorezuar nga ne: Komenti 1.: - Mungon qasja per bicikleta, shtigjet e bicikletave dhe vendparkimi i tyre. Pergjigjja lidhur me Komentin 1.: - Ne Detyre Projektuese nuk specifikohet qe duhet te kete vendparkim per bicikleta, por specifikohet qe duhet te kete qasje per Bicikleta, per te cilen vleresojme se ka hapësire te mjaftueshme dhe te pershtatshme per qarkullim te Bicikletave dhe ngajshem. Sa i perket Shtigjeve te Bicikletave, iu informojme se siperfaqja e Lokacionit te dhene ne Detyre Projektuese ka qene perafersisht 620m² (e thene perafersisht per arsye se nuk ka pasur matje te sakta te lokacionit ne detyre projektuese), ndersa shputa e objektit ne Projekt Propozimin tone eshte 351m², qe i bie afersisht 269m² e siperfaqes se mbetur per organizimin e te gjitha ketyre permbajtjeve te tjera, siperfaqe e cila eshte shume e vogel per t'i organizuar te gjitha keto permbajtje dhe do te ishte e pamundur qe te perfshiheshin te gjitha brenda lokacionit te dhene, duke marre parasysh se nje pjese te madhe te siperfaqes e marrin edhe parkingjet per automjetet zyrtare, gjelberimi, trotualet, etj. E vetmja menyre qe te perfshihen te gjitha do te ishte nese do te trajtohej edhe hapësira jashte lokacionit te dhene, gje e cila nuk kerkohet ne Detyre Projektuese. Komenti 2.: - Mungon ndriqimi dhe Mobilari Urban. Pergjigjja lidhur me Komentin 2.: - Ndriqimi Urban siq e dijme te gjitha te fushes se Arkitektures dhe Inxhinierise eshte pjese e cila punohet ne fazen e projektit kryesor dhe si e tille nuk perben ndonje problem ne kete faze duke marre parasysh se eshte pjese e cila punohet ne faze te metutjeshme te projektit e jo ne fazen e Projektit Ideor. Gjithashtu edhe mungesa e Mobilarit Urban ne projekt eshte e paperfillshme duke marre parasysh se mund te punohet ne faze te metutjeshme te projektit e jo ne fazen e Projektit Ideor. Komenti 3.: - Mungojne Shkallet emergjente Pergjigjja lidhur me Komentin 3.: - Nuk mungojne shkallet emergjente. Shkallet e projektuara jane komplet te mbyllura dhe te ndara nga hapësirat tjera dhe jane te pozicionuara ne hapësire te skajshme te objektit, duke i bere ato shkalle te cilat mund te perdoren per evakuim ne rast te zjarrit. Keto jane te gjitha te specifikuar edhe ne pjesen e Permbajtjes se projektit Ideor – Mbrojtja nga zjarri, duke i specifikuar te gjitha masat per mbrojtje ndaj zjarrit, evakuim, materiale te rezistueshme ndaj zjarrit etj. te gjitha keto te aplikuar ne projekt e nder to edhe shkallet te cilat funksionojne si shkalle emergjente. Edhe nje here, ne si OE kerkojme nga Komisioni Vleresues qe te tregojne profesionalizem dhe te mos diskriminohen OE te tjere me synimin qe te favorizohet nje OE i caktuar i cili eshte shume e qarte qe ka prezantuar nje Projekt Propozim ne nivel shume te dobet. Duke marre parasysh se OE ne fjale eshte vleresuar me 100% te pikeve ne te dy vleresimet paraprake, perse tani po vleresohet qe ka mangesi ne projekt (te cilat kane qene te qarta qe nga fillimi). Ku eshte pergjegjesia profesionale kur Komisioni Vleresues bie ne kundërshtim me dy vleresimet e veta paraprake. Kerkojme qe komisioni vleresues te tregoj profesionalizem duke mos anuluar Aktivitetin dhe duke bere perzgjedhje dhe poentim te projekteve ne menyre meritore e jo duke i perfshire interesat e perbashketa.

Eshte e papranueshme te anulohet ky konkurs bazuar ne mangesi minimale pasi qe per kete arsye vlen poentimi dhe keto mangesi nuk paraqesin asnje te mete kruciale per projektin e prezentuar nga Ne.

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, operatori ekonomik ankues konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me Ligji i Prokurimit Publik: Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi Neni 80 Perberja dhe Vendimet e Jurise • Rregullorja Nr.001/2022 per Prokurim Publik Neni 55, Pika 55.26 Hapja dhe Vleresimi i Projekteve. Kerkojme nga Paneli Shqyrtues qe te obligoj Autoritetin Kontraktues dhe Komision vleresues qe te veproje sipas Ligjeve ne fuqi dhe te respektoj edhe dy (2) vendimet e kaluara te Panlit Shqyrtues te OSHP-se.

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim: - Operatori Ekonomik FST Engineering të datës 28.03.2025 , ka parashtruar kërkesen për Ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull Prok:“Hartimi i projektit kryesor i objektit Administrativ Komunal -Pejë “Nr. të Prok: 635-24-6877-4-2-3 dhe nr i brendeshen 635-24-045-423

Autoriteti Kontraktues, me datën 01.04.2025 ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

1. Autoriteti Kontraktues, Komuna e Pejës, ju njofton se ankesa e parashtruar nga ana juaj më datë 28.03.2025 nuk mund të merret parasysh dhe është e pa bazuar për shkak të faktit se ne dosje të tenderit janë kërkuar specifikacione të detyrueshme dhe shume me rendësi për zhvillim e realizimit të projektit, pa anashkaluar çdo detaj edhe duke mos favorizuar apo diskriminuar një apo me shume operatorë.

- Kemi vlerësuar dosjen e tenderit me përpikëri duke analizuar dhe bazuar ne pranueshmerin e operatoreve ekonomik .përshtatshmërinë profesionale, kapacitetin teknik dhe profesional dhe specifikat, konstatohet se Operatori Ekonomik nuk përmbushë kërkesat e caktuara.

- Mungesa e casjes për biçikleta — Sipas Komisionit Profesional Inxhinier vlerësojnë se operatori ekonomik nuk i është përmbajtur normave për casje në biçikleta. e sipas të cilit pretendon se nuk është cëkur në detyrë projektuese. Nisur nga vet fakti pika A. P- organizimi dhe dizajni ceket qarte Qasjet për staf dhe vizitore e ndër to dhe pika 2. biçikleta dhe ngjashëm.

- Mungon ndriçimi dhe mobilari urban-Ndriçimi një ndër specifikat kyçe e cila nuk është përfillur nga operatori duke lënë disa hapësira ose zona të pa ndriçuara ose ndriçim të pa mjaftueshëm.

- Mungon shkallët emergjente-Komisioni Profesional i Inxhinierëve në përbërje prej 3(tre) anëtarëve konstatohet se shkallët emergjente janë ndër kërkesat e rëndësishme për implemtimin e këtij projekti e të cilat janë shume të rëndësishme për siguri. Pavarësisht kësaj operatori nuk ka paraqitur shkallët emergjente sipas specifikave.

Për shkak të mos përmbushjes së kërkesave dhe specifikacioneve të caktuara në pa mundësi për realizimin e tyre , kërkesa e operatorit refuzohet. Ndaj ky vendim është marrë pas një shqyrtimi profesional dhe të pa anshëm dhe diskriminues ndaj asnjë operatori ekonomik.

Konsiderojmë se janë fakte të mjaftueshme në përputhje me qëllimin dhe realizimin e projektit:“Hartimi i projektit kryesor i objektit Administrativ Komunal -Pejë “Nr. të Prok: 635-24-6877-4-2-3 dhe nr i brendeshen 635-24-045-423

Duke u mbështetur në neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 10.04.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0250/25, ndërsa me datë 21.04.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2025/0277 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e ofruara nga eksperti teknik lidhur me pretendimet ankimore të paraqitura nga OE ankues, eksperti shqyrtues rekomandon që ankesa të konsiderohet si pjesërisht e bazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues për anulimin e procedurës së prokurimit.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, dhe po ashtu OE nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtruesit e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritues lidhur me rastin.-

Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “FST Engineering” SH.P.K., - eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0250 ka vlerësuar si në vijim:

PËRSHKRIMI I ANKESËS

Operatori Ekonomik FST Engineering SH.P.K. ka parashtruar ankesë ndaj vendimit të Autoritetit Kontraktues – Komuna e Pejës për anulimin e procedurës së prokurimit me titull “Hartimi i Projektit Kryesor të Objektivit Administrativ Komunal – Pejë”. Në ankesë, OE pretendon se vendimi për anulim është i paarsyeshëm, joprofesional dhe diskriminues, duke argumentuar se komentet e jurisë profesionale lidhur me mangësitë në projektin e dorëzuar janë të papërfillshme dhe se ato do të mund të adresoheshin në fazën e projektit kryesor. Gjithashtu, OE vlerëson se komisioni ka favorizuar një operator tjetër dhe ka vepruar në kundërshtim me vendimet e mëparshme të OSHP-së.

ANALIZA E EKSPERTIT SHQYRTUES DHE EKSPERTIT TEKNIK

Eksperti shqyrtues dhe eksperti teknik kanë analizuar me kujdes pretendimet ankimore të ankuesit dhe veprimet e AK-së, duke paraqitur konstatimet dhe vlerësimet e tij si më poshtë:

Pretendimi ankimor 1:

Ankuesi FST Engineering SH.P.K., në ankesën e parashtruar pranë OSHP-së, pretendon se komenti i Komisionit Vlerësues lidhur me mungesën e qasjes për biçikleta, shtigjeve të biçikletave dhe vendparkimit për to është i paarsyeshëm, duke theksuar se në Detyrën Projektuese nuk është specifikuar nevoja për vendparkim për biçikleta, por vetëm për qasje për biçikleta. Sipas ankuesit, në lokacionin e dhënë ka hapësirë të mjaftueshme për qarkullim të biçikletave dhe të ngjashme, ndërsa përfshirja e shtigjeve për biçikleta në këtë fazë konsiderohet e panevojshme për shkak të sipërfaqes së kufizuar prej rreth 620 m² të parcelës, prej të cilës vetëm 269 m² kanë mbetur të lira për organizim pas vendosjes së shputës së objektit. Ankuesi vlerëson se do të ishte e pamundur përfshirja e të gjitha përmbajtjeve të kërkuara, përfshirë shtigjet e biçikletave, brenda kësaj hapësire pa u tejkaluar lokacioni i përcaktuar në Detyrën Projektuese, çka nuk është kërkuar nga AK.

Përgjigje ndaj pretendimit ankimor 1:

Eksperti Teknik sqaron se, lidhur me pretendimin nr. 1 të OE ankues, AK te kërkesa në Dosje të Tenderit te pjesa:

PËRMBAJTJA E OBLIGUESHME E HAPËSIRAVE, AK ka kërkuar:

A.Parteri – Organizimi dhe dizajni

o Qasjet për staf dhe vizitor

- Bicikleta dhe ngjashëm

Te propozimi i ofertuesit me kodin 1610 nuk është përfshirë në propozim kjo kërkesë në pjesën e vizatimeve, vizualizimeve e gjithashtu nuk është e përshkruar në përshkrimin Teknik e as në paramasë dhe parallogari.

Andaj pretendimi i OE ankues është i pabazuar.

Pretendimi ankimor 2:

Sa i përket komenteve të Komisionit Vlerësues lidhur me mungesën e ndriçimit dhe mobiliarisë urbane, ankuesi shpreh kundërshtim duke konsideruar se vërejtjet janë të pabazuara. Ai thekson se ndriçimi urban, sipas praktikave të zakonshme të projektimit, trajtohet në fazën e projektit kryesor dhe jo në fazën ideore, andaj mungesa e përfshirjes së tij nuk përbën lëshim. Po ashtu, sa i përket mobiliarisë urbane, ankuesi vlerëson se ajo nuk ka qenë e përcaktuar qartë në Detyrën Projektuese si element i domosdoshëm për këtë fazë, dhe se trajtimi i saj në fazën e mëvonshme do të ishte i mjaftueshëm. Sipas ankuesit, këto mungesa nuk kanë karakter substancial dhe nuk duhet të ndikojnë në përgjegjshmërinë apo cilësinë e projektit të paraqitur.

Përgjigje ndaj pretendimit ankimor 2:

Eksperti Teknik sqaron se, lidhur me pretendimin nr. 2 të OE ankues, AK te kërkesa në Dosje të Tenderit te pjesa:

PËRMBAJTJA E OBLIGUESHME E HAPËSIRAVE, ka kërkuar:

A. Parteri – Organizimi dhe dizajni

- o Ndriçimi
- o Mobiliari urban

Te propozimi i ofertuesit me kodin 1610 nuk është përfshirë në propozim kjo kërkesë në pjesën e vizatimeve; në pjesën e vizualizimeve shihen disa trupa ndriçues, por të cilët nuk janë përshkruar në përshkrimin teknik e as në paramasë dhe parallogari, ndërsa pjesa e mobiliarit urban nuk është paraqitur fare.

Andaj pretendimi i OE ankues është i pabazuar.

Pretendimi Ankimor 3:

Në vijim të ankesës, ankuesi ka ngritur shqetësimin se Komisioni Vlerësues ka bërë vlerësim të pasaktë kur ka konstatuar mungesën e shkallëve emergjente në projektin e tij. Sipas tij, shkallët ekzistuese të projektuara janë të mbyllura, të ndara nga hapësirat e tjera dhe të pozicionuara në skaje të objektit, çka i bën të përshtatshme për evakuim në rast zjarri. Ankuesi thekson se në përmbajtjen e projektit ideor, konkretisht në seksionin mbi mbrojtjen nga zjarri, janë të specifikuara masat për mbrojtje dhe evakuim, përfshirë përdorimin e shkallëve të mësipërme si shkallë emergjente. Ai vlerëson se ky aspekt është trajtuar me seriozitet dhe përputhet me kërkesat e projektimit për këtë fazë.

Përgjigje ndaj pretendimit ankimor 3:

Eksperti Teknik sqaron se, lidhur me pretendimin nr. 3 të OE ankues, AK te kërkesa në Dosje të Tenderit te pjesa:

PËRMBAJTJA E OBLIGUESHME E HAPËSIRAVE, ka kërkuar:

B. Ndërtesa – Pjesa për staf

o Hapesira per Shkallet kryesore, emergjente dhe liftat

Te propozimi i ofertuesit me kodin 1610 kjo kërkesë është paraqitur, dhe janë propozuar si shkallë emergjente të shfrytëzohen shkallët kryesore, janë paraqitur vizatimet, është përshkruar në përshkrimin teknik, mirëpo kërkesa e AK-së në dosje të tenderit ka qenë që të ketë shkallë kryesore, emergjente.

Andaj pretendimi i OE ankues është i pabazuar.

Pretendimi ankimor 4: (Favorizimi, trajtimi i pabarabartë dhe mospërputhja me vendimet e OSHP-së)

Ankuesi pretendon se gjatë gjithë zhvillimit të aktivitetit të prokurimit është treguar trajtim i pabarabartë dhe favorizim i hapur ndaj një OE-je tjetër, i cili në dy fazat paraprake është vlerësuar me 100% të pikëve nga Komisioni Vlerësues, pavarësisht mangësive evidente në projektin e tij. Sipas ankuesit, këto mangësi janë evidentuar qysh në ankesën e parë dhe janë konfirmuar nga Paneli Shqyrtues i OSHP-së, i cili në dy raste ka konstatuar se vlerësimi i AK-së ishte i pabazuar dhe ka rekomanduar rivlerësim.

Ankuesi vlerëson se, në vend se të përmirësonte qasjen pas këtyre ndërhyrjeve, AK ka përsëritur të njëjtin vlerësim në vendimin e dytë, duke injoruar rekomandimet e OSHP-së dhe duke vazhduar me të njëjtën praktikë që, sipas tij, bie ndesh me parimin e barazisë në trajtim dhe me nenin 7 të LPP-së.

Në lidhje me vendimin e tretë, për anulimin e procedurës, ankuesi pretendon se ai përfaqëson një shmangie të qëllimshme nga zbatimi i një vlerësimi meritues, për të mos përzgjedhur fituesin real. Ai e konsideron këtë si një përpjekje për të mbrojtur OE-në e mëparshme të favorizuar dhe si mosrespektim të vendimeve të OSHP-së, në kundërshtim me nenin 131 të LPP-së, i cili e përcakton qartë se vendimet e OSHP-së janë të detyrueshme për AK-në.

Në përfundim, ankuesi kërkon ndërhyrjen e Panelit Shqyrtues për të garantuar respektimin e parimeve të barazisë, transparencës dhe zbatimin e plotë të vendimeve të mëparshme të OSHP-së.

Përgjigje ndaj pretendimit ankimor 4:

Eksperti shqyrtues, lidhur me pretendimin e OE ankues për favorizim, trajtim të pabarabartë dhe mospërputhje me vendimet e mëparshme të OSHP-së, sqaron se nga dokumentacioni rezulton se në dy fazat e para të aktivitetit të prokurimit, AK ka vlerësuar si më të mirë për fazën e parë projektin e të njëjtit OE, ndonëse ndaj këtij projekti ishin ngritur pretendime për mangësi. Këto pretendime janë pranuar si të bazuara nga Paneli Shqyrtues i OSHP-së, i cili në dy raste ka kërkuar rivlerësim.

Pavarësisht kësaj, AK në vendimin e dytë ka mbajtur të njëjtin vlerësim për të njëjtin OE, ndërsa vetëm në fazën e tretë ka ndryshuar pozicion duke anuluar tërë procedurën me arsyetimin se asnjë projekt nuk i përmbushte kërkesat.

Ky zhvillim ka krijuar perceptimin e trajtimit të pabarabartë dhe ka ngritur shqetësime për koherencën dhe objektivitetin e procesit të vlerësimit, në raport me nenin 7 të LPP-së, i cili përcakton parimin e trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit të operatorëve ekonomikë. Në këtë kontekst, është me rëndësi të potencohet se AK nuk ka siguruar se vendimet e jurisë janë marrë në harmoni me kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit, si dhe në përputhje me nenin 80 të LPP-së dhe nenin 55 të Rregullores për Prokurim Publik, që përcaktojnë detyrimet për vlerësim profesional, të argumentuar dhe në bazë të kriterëve të parashtruara.

Nga ana tjetër, edhe vetë ankuesi në ankesën drejtuar OSHP-së ka pranuar se disa elemente të kërkuara në projekt nuk janë përfshirë plotësisht, duke i vlerësuar ato si të papërfillshme ose të zbatueshme në faza të mëvonshme.

Pretendimi i OE ankues vlerësohet si pjesërisht i bazuar, për faktin se AK, pavarësisht vërejtjeve dhe rekomandimeve të dyfishta nga OSHP-ja, ka përsëritur të njëjtin vlerësim duke e renditur si projektin më të mirë të njëjtin OE. Kjo qasje ka ngritur dyshime të arsyeshme për mungesë koherence në procesin e vlerësimit dhe për trajtim të pabarabartë në raport me parimet e nenit 7 të LPP-së.

Megjithatë, në mungesë të dëshmive konkrete për ndërhyrje të qëllimshme ose favorizim të drejtpërdrejtë, pretendimi nuk mund të konstatohet si plotësisht i bazuar në kuptimin juridik dhe teknik të fjalës, andaj mbetet i pjesërisht i bazuar.

PËRFUNDIM

Mbështetur në të dhënat e paraqitura dhe në analizën e detajuar për secilin pretendim, eksperti shqyrtues vlerëson se ankesa e operatorit ekonomik FST Engineering SH.P.K. vlerësohet pjesërisht e bazuar.

Në disa prej pretendimeve të tij, ankuesi ka ngritur çështje legjitime që lidhen me mënyrën e zhvillimit të procedurës dhe trajtimin nga Autoriteti Kontraktues, veçanërisht në raport me vlerësimin e projektit të një OE-je tjetër në mënyrë të përsëritur, pavarësisht rekomandimeve të mëparshme të OSHP-së. Kjo qasje ngrre dyshime të arsyeshme për mungesë të koherencës në vendimmarrje dhe për trajtim jo të balancuar, në kundërshtim me parimet e përcaktuara në nenin 7 të LPP-së.

Megjithatë, edhe vetë ankuesi, në ankesën e tij, ka pranuar se disa elemente të kërkuara në projekt nuk janë përfshirë plotësisht, duke i konsideruar ato si të papërfillshme ose të adresueshme në faza të mëvonshme. Kjo tregon se projektpropozimi i tij nuk ka qenë në përputhje të plotë me kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit dhe e kufizon vlerësimin e pretendimeve të tij si tërësisht të bazuara.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në platformën e e-prokurimit, pretendimeve ankimore, përgjigjeve të dhëna nga eksperti i çështjes i angazhuar nga OSHP, konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilave dispozita kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e

shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e “Hartimi i Projekti kryesor i objektit Administrativ Komunal -Pejë” me nr. të prokurimit: 635-24-6877-4-2-3.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik “FST Engineering” SH.P.K., te aprovohet si pjesërisht e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Hartimi i Projekti kryesor i objektit Administrativ Komunal -Pejë” me nr. të prokurimit: 635-24-6877-4-2-3 të mbetet në fuqi vendimi i AK. Paneli Shqyrtues duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartpërmendura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës, ankesën e operatorit ekonomik e sheh si pjesërisht të bazuar, Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – “KOMUNA E PEJËS” lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Hartimi i Projekti kryesor i objektit Administrativ Komunal -Pejë” me nr. të prokurimit: 635-24-6877-4-2-3, të mbetet në fuqi vendimi i AK-së lidhur me aktivitetin e prokurimit.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E PEJES**
- **OE - FST Engineering SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: